



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800642/2

Tiranë __. __. 2018

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm, në përputhje me kushtet higjieno-sanitare për banorët e Tiranës.*

Drejtuar : **z.Redi MOLLA**
Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizime
Drejtor

Drejtuar : **z. Ndriçim SHANI**
Komisionit Kombëtar të Entit Rregullator të Ujit
Kryetar

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë Qendra "Res Publica" në të cilën ankohet ndaj "Ujësjetës-Kanalizime" Tiranë, në lidhje me marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin me ujë të pijshëm, në përputhje me kushtet higjieno-sanitare për banorët e Tiranës.

Konkretisht, ankuesi pretendon se prej vitesh qytetarët e Tiranës në mënyrë të vazhdueshme kanë ngritur problematikën e mos përdorimit të ujit të pijshëm për konsum dhe gatim, pasi uji i furnizuar shtëpitë e tyre nga rrjeti i ujësjetës nuk përmbush standardet dhe nuk ka cilësinë e duhur për t'u konsumuar.

Për të mundësuar furnizimin me ujë të pijshëm, qytetarët e interesuar kanë zgjedhur mënyra të ndryshme, duke shkuar në Dajt për të mbushur ujë ose duke e blerë atë¹, duke iu shkaktuar në këtë mënyrë kosto financiare shtesë në jetesën e tyre.

Të tjerë qytetarë të pa informuar konsumojnë ujin e furnizuar duke sjellë pasojë në shëndetin e tyre.

Sipas një kërkesë për informacion drejtuar Ujësjetës Kanalizimeve, Tiranë sh.a na është vënë në dispozicion informacion për analizat ditore të *ujit të pijshëm* për një periudhë 2016-2017, bashkangjitur ankesës ku rezultoi se:

¹ <https://www.rtsh.al/lajme/uji-i-pijshem-ende-problem-ne-tirane/>

- a- Në një numër të madh ditësh në zona të ndryshme të Tiranës niveli i *escherichia coli* është më shumë se norma e lejuar sipas rregullores për ujin e pijshëm e cila përcakton këtë parametër në nivelin 0, (shih shtojcën 1 të VKM nr 379, dt 25.05.2016). E njëjta gjë ka ndodhur më rrallë me nivelin e *streptococci faecal*. Ndërkoh niveli i Klorit rezulton shpesh herë të jetë mbi 0.5. Sipas këtyre analizave rezulton që në një frekuencë relativisht të shpeshtë uji nuk përmbush standardet e lejuara.
- b- Sipas analizave rezulton se nuk janë analizuar një sërë faktorësh të tjerë mikrobiologjik apo kimik që ka përcaktuar rregullorja e cilësisë së ujit të pijshëm. Në këtë mënyrë nuk ekziston asnjë garanci që këto parametra janë përmbushur.
- c- Këto analiza janë bërë në cdo rast nga një laborator i porositur nga tregtari, i cili nuk rezulton të jetë i akredituar.

Kuadri ligjor: Në kushtet kur qytetarët kanë lidhur një kontratë me ujësjellësin, për tu furnizuar me *ujë të pijshëm* sipas cilësisë dhe standardeve më të larta dhe paguajnë të gjitha detyrimet sipas kontratës, është detyra e Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë për të furnizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe brenda cilësisë ujin e pijshëm në banesat e qytetarëve.

Në nenin 29 të ligjit 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar parashikohet se: *Mallrat prezumohen në përputhje me kontratën kur:*

- a) përputhen me përshkrimin e dhënë nga shitësi dhe zotërojnë cilësitë e mallit, që shitësi ia ka paraqitur konsumatorit si mostër ose si model;
- b) përputhen me qëllimet e veçanta, për të cilat konsumatori i ka kërkuar dhe që i bëhen të njohura shitësit në çastin e lidhjes së kontratës;
- c) përputhen me qëllimet, për të cilat mallrat e të njëjtit tip përdoren normalisht;
- ç) paraqesin cilësitë dhe performancën, të cilat janë normale për mallra të të njëjtit tip dhe që konsumatori, në mënyrë të arsyeshme, i pret, sipas natyrës së mallit dhe duke marrë parasysh karakteristikat e mallit, të bëra nga shitësi, prodhuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, në deklaratat publike, veçanërisht në publicitetet ose etiketimet.

Gjithashtu në nenin 33/1 të këtij ligji parashikohet se:

“Tregtari i ofron konsumatorit shërbime në përputhje me kushtet e kontratës. Tregtari është përgjegjës për mospërputhjet e shërbimit të siguruar konsumatorit me kushtet e kësaj kontrate.”

Në pjesën VII të këtij ligji, ku parashikohen dispozita të veçanta për kontratën e shërbimit të ujit, konkretisht në nenin 41 është shprehur se:

1. *Tregtari garanton siguri, cilësi dhe vazhdueshmëri të shërbimeve.*
2. *Sigurimi i lidhjes, i rrjetit të shpërndarjes, si dhe i shërbimit të mirëmbajtjes për energjinë, ujin dhe telekomunikacionin bëhen për të gjithë konsumatorët në kushte të njëjta dhe jodiskriminuese.*

3. Konsumatorit i lind e drejta për t'u dëmshpërblyer:

a) në rastet e ndërprerjeve teknike, të cilat nuk janë shkaktuar nga forca madhore ose nga vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe kur nuk janë lajmëruar më parë dhe kanë penguar konsumatorin nga përdorimi i këtyre shërbimeve për një periudhë më të gjatë se 24 orë;

b) kur shërbimi i ofruar është me të meta dhe i ka sjellë dëme konsumatorit.

Të nderuar Zotërinj,

Problematika që prezantohet në këtë ankesë është tepër e rëndë dhe serioze në drejtim të shëndetit të konsumatorëve dhe megjithëse ekziston prej disa kohësh ende nuk janë arritur rezultate konkret në drejtim të garantimit me cilësi të këtij shërbimi publik edhe pse konsumatori është i detyruar të paguajë për këtë shërbim.

Institucioni i Avokatit të Popullit prej kohësh ka patur një impenjim maksimal në drejtim të garantimit dhe respektimit të të drejtave të konsumatorit, kundrejt operatorëve që ofrojnë shërbime publike në vend dhe aq më tepër në rastin konkret kur lidhet edhe drejtëpërdrejt me shëndetin e individëve.

Rëndësia e cilësisë të ujit të pijshëm është një domosdoshmëri absolute për jetën, dhe ofrimi i këtij shërbimi jashtë kushteve higjieno-sanitare mund të jetë gjithashtu një burim i sëmundjeve me origjinë ujore, madje edhe shkaktar i vdekjeve, nëse ai është i ndotur dhe i pamjaftueshëm.

Sasia dhe cilësia e ujit që konsumohet për çdo banor në një vend të caktuar shprehet indirekt edhe në nivelin higjieno-sanitar për banorët e një vendi dhe orienton për masat që duhet të merren për cilësi të mirë të tij. Në këtë këndvështrim në aspektin higjieno-sanitar, uji nuk duhet të plotësojë vetëm kërkesat kualitative (cilësitë mikrobiologjike dhe fiziko-kimike) të tij, por edhe kërkesat kuantitative (ose sasiore) (Directive 2000/60/EC).

Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin me ujë të pijshëm, në përputhje me kushtet higjieno-sanitare për banorët e Tiranës, pasi kjo përbën një nevojë emergjente duke patur parasysh edhe Direktivën e Ujit të Pijshëm 98/83/KE datë 03.11.1998, që ka të bëjë me një kompleks normash që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut duke vendosur kritere për shëndetin dhe pastërtinë.

E drejta për furnizim me ujë të pijshëm në përputhje me kushtet higjieno-sanitare është përcaktuar edhe në Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e konsumatorit në të cilën citohet se: *“Qeveritë duhet që brenda objektivave dhe synimeve të përcaktuara në Dekadën Ndërkombëtare për furnizimin me Ujë të pijshëm dhe për higjenën, të formulojnë, të mbajnë dhe fuqizojnë politikat kombëtare për të përmirësuar furnizimin, shpërndarjen dhe cilësinë e ujit të pijshëm.....”*

Gjithashtu, ligji nr. 8849/2001, *“Për ratifikimin e protokollit për ujin dhe shëndetin, sipas Konventës të vitit 1992, Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujrave ndërkuftarë dhe liqeneve ndërkombëtare”*, në nenin 4 të tij citohet se:

1. *Palët do të marrin të gjitha masat përkatëse për të parandaluar, kontrolluar dhe pakësuar sëmundjet e transmetuara nëpërmjet ujit, në kuadrin e sistemeve të administrimit të integruar të ujit me qëllim përdorimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, cilësisë së ujit që nuk rrezikon shëndetin publik dhe mbrojtjen e ekosistemeve të ujit.*

2. *Palët në veçanti do të marrin masat përkatëse me qëllim sigurimin të:*

(a) furnizimit adekuat me ujë të pijshëm të shëndetshëm, që nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe substanca, të cilat, në vartësi të numrit apo përqendrimit të tyre, përbëjnë një rrezik potencial për shëndetin publik. Kjo do të përfshijë mbrojtjen e burimeve ujore, të cilat janë përdorur si burime për ujë të pijshëm, trajtimin e ujit dhe vendosjen, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kolektive;

(b) sanitet të përshtatshëm, të një standardi që, në mënyrë efektive, mbron shëndetin publik dhe mjedisin....

Pra, të gjitha këto akte ligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrja e masave të menjëhershme për furnizimin me ujë të pijshëm në përputhje me standartet e kërkuara si një nevojë emergjente duke patur parasysh kushtet tani edhe të stinës së verës, dhe për të mos cënuar në asnjë rast shëndetin e këtyre qytetarëve.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, konstatohet se e drejta e konsumatorëve për këtë zonë në drejtim të furnizimit me ujë sipas standarteve të kërkuara është inekzistent.

Sa më sipër, në kushtet kur nga Ujësjellës Kanalizimi Tiranë nuk janë përmbushur detyrimet dhe kushtet e parashikuara në kontratën e shërbimit të ujit, të lidhur midis qytetarëve dhe UKT-së, duke cënuar në këtë mënyrë të drejtat e konsumatorit, pasi furnizimi me ujë të pijshëm nuk përmbush standartet dhe cilësinë për konsum, kërkohet që në bazë të nenit 52, 55 të ligjit 9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të vendoset:

Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin me ujë të pijshëm, në përputhje me kushtet higjeno-sanitare për banorët e Tiranës duke:

- Rekomanduar UKT sha të kryejë të gjithë analizat sipas rregullores
- Rekomanduar UKT sha të zgjedhë një laborator të akredituar për bërjen e këtyre analizave
- Rekomanduar UKT sha të rimbursojë të gjithë abonentët sipas zonave përkatëse, në rastet kur uji nuk ka përmbushur standartet e përcaktuar në VKM nr 379, datë 25.05.2016, “Për miratimin e rregullores “cilësia e ujit të pijshëm””

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë, ndaj ne kërkojmë marrjen e veprimeve konkrete për realizimin e furnizimit normal në kushte higjieno-sanitare brenda një kohe sa më të shkurtër për këta banorë pasi anashkalimi i detyrave tuaja funksionale për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm e cilësinë e domosdoshme të tij, është një shkelje e rëndë administrative që ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës.

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron ofrimin e shërbimit publik të furnizimit me ujë të pijshëm si një nevojë thelbësore për individët dhe për rrjedhim një të drejtë elementare për ta poseduar atë lirisht në përputhje me standartet. Ndaj dhe çdo keqmenaxhim i këtij shërbimi është një shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të shtetasve, nuk mund të gjejë tolerance, si dhe nuk i përgjigjet standarteve minimale të një vendi që ka në qendër të vet të drejtat e njeriut, mirëqënien e qytetarëve dhe aspiron të hyjë sa më shpejt në Bashkimin Europian.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtuam, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të Nenit 21/b të ligjit Nr.8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse), ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin me ujë të pijshëm, në përputhje me kushtet higjieno-sanitare për banorët e Tiranës duke:

- Rekomanduar UKT sha të kryejë të gjithë analizat sipas rregullores,
- Rekomanduar UKT sha të zgjedhë një laborator të akredituar për bërjen e këtyre analizave
- Rekomanduar UKT sha të rimburojë të gjithë abonentët sipas zonave përkatëse, në rastet kur uji nuk ka përmbushur standardet e përcaktuar në VKM nr 379, dt 25.05.2016, *“Për miratimin e rregullores “cilësia e ujit të pijshëm”*”

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, lutemi na ktheni përgjigje të argumentuar brenda afatit 30 ditor lidhur me masat ligjor dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi,

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R

Arben SHKËMBI